




**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCJIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

DATE/A:	29.03.2016
REFERENC-Ë:	<i>AKK-DPKPP 03-03/1202/16</i>
PËR/ZA/TO:	z. Artan JAHA, Shef i Divizionit të Prokurimit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
CC:	z. Kapllan HALIMI, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI <i>Haseni</i> Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " <b>Shërbime hotelierike për nevoja zyrtare të MBPZHR-së</b> "

*I nderuari z. JAHA ,*

Në mbështetje të nenit 142 par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 par. 1, nënpar. 1.1. dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 par. 4, 9 par. 1, nënpar. 1.6, 12 par. 2 dhe 19 par. 1, nënpar. 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin " **Shërbime hotelierike për nevoja zyrtare të MBPZHR-së (mbajtja e seminareve, konferencave etj )** " me numër të prokurimit: 11303-016-005-221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

## O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin " Shërbime hotelierike për nevoja zyrtare të MBPZHR-së (mbajtja e seminareve, konferencave etj.)" me numër të prokurimit: 11303-016-005-221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të ligjit nr. 05/1 - 068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/1-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/1-237.

## *Arsy etimi*

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 22.03.2016, ka nxjerrë vendim me numër protokolli AKK-03-03-1202/16 për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "Shërbime hotelierike për nevoja zyrtare të MBPZHR-së (mbajtja e seminareve, konferencave etj.)" me numër të prokurimit: 11303-016-005-221, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit për këtë procedurë të prokurimit, Agjencia ka konstatuar se në njoftimin për kontratë i cili është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së dhe dosjen e tenderit e cila është përgatitur për këtë kontratë, Autoriteti kontraktues tek **rubrika kërkesat mbi mundësitë teknike ose profesionale pika 9.2 pjesa vërejtje ka kërkuar që Hoteli nuk duhet të jetë më larg se 10 km nga MBPZHR-ja**, kërkesë kjo për të cilën konsiderojmë se bie ndesh me nenin 7 të Ligjit për prokurimin publik.

Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se me formulimin e këtij kriteri tek pika 9.2 dosjes së tenderit, ju si Autoritet kontraktues keni bërë diskriminim territorial në kundërshtim me Ligjin në fuqi për prokurimin publik ku sipas këtij ligji në mënyrë decisive thuhet se *“ Autoriteti Kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik “*. Me formulimin e kësaj kërkesë ju keni diskriminuar Operatorët Ekonomik që janë në largësi më tepër se 10 km dhe në të njëjtën kohë keni krijuar kushte favorizuese për Operatorët Ekonomik që janë brenda perimetrit prej 10 km.

Njësia kërkuese pranë Autoritetit kontraktues duhet të ketë kujdes që me rastin e formulimit të specifikimeve teknike të mos formuloj specifikime favorizuese për Operator ekonomik të caktuar e në të njëjtën kohë t'i diskriminoj Operatorët tjerë ekonomik. Autoriteti kontraktues duhet t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues e ka të ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

Konsiderojmë se veprimet e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me, nenin 7 Barazia në Trajtim Jo-Diskriminimi të ligjit nr. 05/1 -068 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/1-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/1-237.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë kundër Korrupsionit për veprimet e ndërmarra.

**Me respekt !**